

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

---

### Reflektimi / *et-Tefekkur* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

“Ne ta shpallëm Kujtimin (Kuranin) që t’u sqarosh njerëzve se çfarë u është zbritur dhe që të reflektojnë.” (en-Nahl, 44)

Reflektimi është një hulumtim për arritjen e të kuptuarit të thellë në kërkim të qëllimit përfundimtar, dhe kjo ndahet në tri lloje:

- Reflektimi për thelbin e teuhidit (njësisë së Allahut)
- Reflektimi për aktet e Tij të mrekullueshme dhe për krijesat
- Reflektimi për realitetet e veprimeve dhe të gjendjeve tua (të brendshme)

Reflektimi për thelbin e teuhidit nënkupton lundrimin e guximshëm në oqeanin e mohimit<sup>1</sup>, ku nuk mund të mbijetosh ndryshe veçse duke u strehuar në dritën e zbulimit<sup>2</sup> dhe duke u kapur për shkencën e jashtme (tekstuale; Kuranin dhe Sunetin).

---

<sup>1</sup> Mohimit të teuhidit të vërtetë, meqë teuhidi i vërtetë, sipas autorit (el-Harawi), ndodh pas asgjësimit të vetvetes (egos). Domethënë, për sa kohë që njeriu të jetë i vetëdijshëm për reflektimin që bën apo për “veten” që reflekton, s’do ta ketë realizuar kuptimin e njëmendtë të njësisë (teuhidit) së Tij dhe do të mbetet në mohim. Tërë kjo bazohet në konceptin e autorit për *fanaa*-në apo asgjësimin e vetvetes. Në anën tjetër, koncepti sunit i *fanaa*-s mund të përshkruhet si asgjësim i të gjitha dëshirave e ndjekjeve karshi ndjekjes së kënaqësisë së Tij dhe asgjësim i (pasjes parasysh të) krijesave në kalkulimin e atij që gjithmonë sheh vetëm Allahun. I këtilli, në fakt, ndien ekzistimin e krijesave, por ato asnjëherë nuk e pengojnë nga shikimi i hyjnores, të Vërtetit, Fillimit të të gjitha gjërave. Me fjalë të tjera, kur krijesat të lëndojnë apo të sjellin dobi, në këto veprime të tyre ti sheh vetëm caktimin e Allahut dhe punët e Tij; përgjigjja jote në veprimet e tyre do të jetë vetëdija për Të, jo për ata (apo çfarë bëjnë ata).

<sup>2</sup> *Keshf* (zbulimi) haset shpesh në shkrimet sufite. Kjo zakonisht përdoret në kontekstin e zbulimit të diçkaje nga dimensionin e së fshehtës për kërkuesin. E fshehta është relative dhe absolute. Relativja është e njohur për disa nga krijesat e Allahut, siç është një ngjarje që ndodh në Kinë në çastin që ti lexon këtë ndërsa gjendesh në dhomën tënde. Domethënë, kjo është e fshehtë për ty, por jo dhe për të gjitha

Për sa i përket reflektimit për aktet e Tija të mrekullueshme dhe krijimet, kjo përbën ujin që vadit farat e urtësisë.

Dhe reflektimi për realitetet e veprimeve dhe të gjendjeve tua (të brendshme) mundëson udhëtimin në shtegun e së vërtetës.

Në reflektimin për thelbin e teuhidit mund të shpëtosh në tri mënyra:

- Duke kuptuar paaftësinë e intelektit tënd<sup>3</sup>
- Duke u dëshpëruar nga realizimi i objektivit skajor<sup>4</sup>
- Duke u strehuar në fortesën e lartësimit të Tij (*ta'dhim*)<sup>5</sup>

Aktet e Tija të mrekullueshme dhe krijesat vlerësohen në tri mënyra:

- Duke reflektuar për origjinën e mirësive që ke
- Duke u përgjigjur në sinjalet hyjnore<sup>6</sup>
- Duke ikur nga robërimi ndaj dëshirave

---

krijesat. Allahu mund t'u shfaqë disa prej kërkuesve diçka nga e fshehta relative në formë të një *kerameti* apo për t'ua forcuar besimin. Disa sufinj e teprojnë për atë çfarë mund t'i zbulohet një evliaje (të afërmi të Allahut), aq sa i atribuojnë edhe dije që i përket vetëm Allahut. *Keshf* apo zbulimi po ashtu mund t'i referohet dhënies së të kuptuarit të drejtë të realiteteve të ekzistencës dhe të fesë. Përderisa ky zbulim i nënshtrohet sheriatit të pejgamberit të Allahut, është një koncept i shëndoshë. Çfarëdo mendime për të cilat mund të frymëzohet njeriu, duhet ta kalojnë testin e përputhshmërisë me shpalljen (Kuranin dhe Sunetin). Ebu Sulejman ed-Darani tha: "Nganjëherë më shfaqet në zemër një mendim i ndjekësve (të shtegut hyjnor), por unë nuk e pranoj pa dy dëshmitarët besnikë: Librin dhe Sunetin." (*Tabekaat es-Suffije* nga es-Sulemij)

<sup>3</sup> Ti duhet ta humbësh shpresën se do ta kuptosh plotësisht thelbin e hyjnore nëpërmjet intelektit. Ajo që ka fund, s'mund ta kuptojë krejtësisht atë që s'ka fund. Intelekti s'është në gjendje ta gjykojë apo ta matë atë që s'e ka perceptuar ndonjëherë.

<sup>4</sup> Atëherë, do të jesh i kënaqur me atë që thuhet për Allahun e për Cilësitë e Tij dhe nuk do të kërkosh ta ndjekësh atë që është e fshehur për ty në këtë botë.

<sup>5</sup> Duhet shmangur nga çdo orvatje për t'i modifikuar Cilësitë e Tij duke e lartësuar Atë mbi të gjitha krahasimet dhe imagjinatat.

<sup>6</sup> Këto të ndodhin shpesh, por ti i shpërfill. Këto janë shkëndija drite, sinjale që Ai të çon vazhdimisht për të të kthyer, nëse ke humbur; për të ta rritur imanin, për ta dhënë ndonjë mësim, etj. Ata që reflektojnë, u përgjigjen këtyre sinjaleve vazhdimisht. Ata i vërejnë këto sinjale dhe i njohin. Prej këtyre shenjave ka që vijnë shpesh, siç është ndonjë rast vdekjeje i ndonjë të afërmi, etj.

Nëpërmjet reflektimit, ti mund t'i kuptosh shkallët e veprimeve dhe gjendjet e tua (të brendshme) në tri mënyra:

- Duke qenë i përkushtuar ndaj dijes shariatike
- Duke vënë në dyshim të gjitha gjendjet e jashtme<sup>7</sup>
- Duke identifikuar shkallët e të tjerëve

---

<sup>7</sup> Jo vetëm ato të kësaj bote, si pasuria dhe pushteti, por edhe obligimet dhe aktet fetare, si: namazi, sadakaja, dhe agjërimi. Njeriu s'bën të mashtrohet nga këto. Këto s'bën të jenë tema kryesore e devotshmërisë së njeriut; vetëm Allahu është.